

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.139/2015, “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i këtij projektligji vjen si rezultat i punës së qeverisë për të përfaqësuar e nxitur politikat e bashkëpunimit e të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur dhe fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë, si dhe për të mbrojtur interesat e shtetit brenda fushave të përgjegjësisë, sipas pikës 3, të vendimit nr.510, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Diasporën”.

Ndryshimi në këtë projektligj vjen si rezultat i kërkesave imediate për implementimin e plotë të dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve, qasjen drejt një ndërgjegjeje evropiane në drejtim të afirmimit të padiskutueshëm të rëndësisë që ka diaspora në ndërtimin e urave lidhëse me vendin e origjinës, ndërgjegjësimin për influencën pozitive që ka diaspora në zhvillimin ekonomik, politik e kulturor të vendit të origjinës.

Në këtë kontekst, ky projektligj propozohet në vazhdim të punës së ndjekur deri më tani për krijimin e infrastrukturës ligjore, ku përmendim ligjin nr.115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën”, ligjin nr.16/2018, “Për diasporën”, ligjin nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, si edhe Strategjinë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, të cilat mbështesin nga pikëpamja rregullatore zhvillimin e raporteve me diasporën, por që tashmë kjo infrastrukturë ligjore duhet të shtrihet edhe në nivel vendor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave, ku çështja e shqiptarëve në botë zë një vend të mëvetësishëm në kuadër të orientimit për politikën e jashtme dhe të sigurisë, integrimin evropian

dhe shqiptarët në botë. Në këtë aspekt, hartimi i projektligjit është hap i rëndësishëm në procesin e implementimit të reformës ligjore dhe institucionale për ndërtimin e marrëdhënieve të natyrshme të atdheut me shtetasit e vet, nëpërmjet dhënies së shërbimeve për diasporën dhe migracionin. Procesi i krijimit të infrastrukturës vendore për realizimin e përgjegjësive konkrete dhe përcaktimin e strukturave shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën është instrument kyç në realizimin e angazhimit politik për të mbështetur e përkrahur komunitetin shqiptar jashtë vendit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj vjen si një propozim në kuadër të masave vazhduese të qeverisë shqiptare për ngritjen e infrastrukturës institucionale, të domosdoshme për zhvillimin e lidhjeve me diasporën, veçanërisht për ndërmarrjen e masave në nivel vendor për realizimin e të drejtave politiko-ekonomike, si edhe social-kulturore të komunitetit shqiptar jashtë vendit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Nga pikëpamja procedurale, në rend hierarkik, propozimi i projektligjit mbështetet në dispozitat kushtetuese për propozimin e projektligjeve nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtimin nga Kuvendi, konkretisht në nenet 78, 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës, në ligjin nr.9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe në rregulloren e brendshme, dalë në zbatim të këtij ligji.

Nga pikëpamja materiale, projektligji gjen mbështetje në nenin 8, të Kushtetutës, i cili parashikon se:

- “1. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj.
2. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet.
3. Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit, për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.”.

Gjithashtu, projektligji është në harmoni dhe me frymën e standardeve ndërkombëtare të konsoliduar në një sërë aktesh të tilla, si: Karta e OKB-së,

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike etj.

Në raport me legjislacionin e zakonshëm, projektligji i propozuar nuk krijon përplasje, pasi legjislacioni aktual ndjek të njëjtën frymë, por, në të njëjtën kohë, ky legjislacion dëshmon pamjaftueshmërinë për adresimin e plotë të nevojave të diasporës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji i propozuar nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 3 nene, si më poshtë vijon:

Në nenin 1 parashikohet që pas nenit 29 të shtohet neni 29/1, me këtë përmbajtje:

“Funksionet e bashkive në fushën e diasporës dhe të migracionit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- a) Krijimin e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë vendore;
- b) Nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe migrantët shqiptarë;
- c) Dhënien e ndihmës e të informacionit për çështje që lidhen me regjistrimin e fitimin e shtetësisë;
- ç) Dhënien e ndihmës e informacionit për legjislacionin shqiptar në fuqi për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni, në fushën e investimeve;
- d) Koordinimin e bashkërendimin e punës me ministritë përgjegjëse për punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës e informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.”.

Në nenin 2 propozohet që në pikën 2, të nenit 12, pas fjalëve “... grupet e interesit ...” të shtohen fjalët “... e përfaqësueseve të diasporës ...”.

Në nenin 3 parashikohet që në nenin 44, fjalët “... 31 mars ...” zëvendësohen me fjalët “... 31 maj ...”, pra, parashikohet zgjatja e afatit.

Sqarim:

- Kuptimin e termit “diasporë” e gjejmë të shprehur në ligjin nr.16/2018, “Për diasporën”;
- Kuptimin e termave “migrant” dhe “migracion” e gjejmë të shprehur në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, si dhe autoritetet e tjera vendore.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga strukturat e ministrit të Shtetit për Diasporën, në përmbushje të detyrave brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore që mbulon ky institucion.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk ka efekte financiare. Struktura e posaçme për diasporën dhe migracionin do të ofrohet nga strukturat ekzistuese pranë bashkive.

KËSHILLI I MINISTRAVE